



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.21

Maj 2005

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## RAPORT

### NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE PËR MUAJIN PRILL 2005

Qendra e Studimeve Parlamentare, në kuadrin e projektit "Rritja e Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Legjislativ" iniciuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare dhe programi i Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (Soros) dhe me mbështetjen financiare të këtij të fundit, gjatë muajit prill, 2005, ka monitoruar veprimtarinë e dy komisioneve të përhershme parlamentare, lidhur me performancën legjislative dhe nivelin e konsultimit dhe pjesëmarrjes së grupeve të interesit dhe publikut në përgjithësi gjatë procesit legjislativ në Kuvend.

**I. Monitorimi i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

#### *Seancat e zhvilluara / Kohëzgjatja e mbledhjeve*

Gjatë muajit prill KÇLAPDNJ ka zhvilluar 12 mbledhje, të cilat kanë qenë të parashikuara në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Mbledhjet kanë qenë të hapura dhe në të shumtën e rasteve ka qenë e pranishme edhe media. Kohëzgjatja mesatare për një mbledhje ka qenë rreth 30 minuta dhe me një kohëzgjatje totale mujore të veprimtarisë legjislative të Komisionit prej 6 orësh. Mesatarisht mbledhjet fillojnë me 15 minuta vonesë nga orari i parashikuar.

Krahasuar me dy muajt e mëparshëm vihet re një ulje e ndjeshme e kohëzgjatjes së  
*(Vijon në faqen 6)*

## Në këtë numër do të lexoni:

**1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin prill 2005**

*faqe 1-5*

**2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore**

*faqe 7*

**3. Raport nga monitorimi i veprimtarisë së komisioneve parlamentare për muajin prill 2005**

*faqe 1,6-7*

**4. Nga Punimet e Kuvendit për muajin prill 2005**

*faqe 1, 8-9*

**5. Kalendar i 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë 16 - 20 maj 2005**

*faqe 10-12*

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave prill 2005

**I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 7.4.2005**

### PROJEKTLIGJE

*(Vendime për propozime projektligjesh)*

1. Për pronësinë industriale
2. Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës
3. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Ko-

*(Vijon në faqen 2)*

## Nga punimet e Kuvendit për muajin prill 2005

I. Projektligje të shqyrtuara në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare

1. P/ligji "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", miratuar në seancë plenare më datë 7 prill 2005.

Projektligji synon të rregullojë çështjen e konfliktit të interesave personale të zyrtarëve të lartë

*(Vijon në faqen 8)*

## Njoftim

*Të nderuar zonja e zotërinj, Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare.*

*Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike*

*(Vijon në faqen 10)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 1)*

rporatës Amerikane "Lockheed Martin Global Ine (LMGI)" për ndërtimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapsirës detare.

**4.** Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, për shmangien e taksimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.

**5.** Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komunitetit European, për parimet e përgjithëshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare.

**VENDIME të Këshillit të Ministrave data 7.4.2005**

**1.** Për autorizimin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror të sektorit strategjik, të rivlersojë pasuritë.

**2.** Për një shtesë në numrin e punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë dhe për rishpërndarje fondesh buxhetore.

**3.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Lindore të Uruguait, për bashkëpunim kulturor.

**4.** Për dhënie mendimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtëshme", të ndryshuar.

**5.** Për miratimin e listës së inventarit dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të maternitetit Elbasan, nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin e Elbasanit.

**6.** Për lejimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për prodhimin e mjeteve lëvizëse për invalidë.

**7.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Akademinë e Shkencave.

**8.** Për emërim dhe lirim nga detyra të anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe largimit e përpunimit të Ujrave të Ndotura.

**9.** Për miratimin në parim të protokollit të sesionit të tretë të komisionit të përbashkët shqiptaro austriak, për bashkëpunim ekonomik.

**10.** Për njohjen ushtarakëve të Forcave të Armatosura si kohë sigurimi të periudhës së trajtimit financiar sipas vendimit nr.225, datë 29.5.1992, të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin Financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura".

**11.** Për ndryshimin e përgjegjësisë të administrimit të sipërfaqes 30.800 m<sup>2</sup>, pjesë e repartit ushtarak nr 4020, Rinas, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së transportit dhe telekomunikacionit, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18. 7. 2003 të këshillit të Ministrave "Për miratimin e Listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësiadministrimi Ministrisë së Mbrojtjes.

**12.** Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, prona private, që preken nga projekti për instalimin e dritareve të uljes në aeroportin "Nënë Tereza" sh.a.

**13.** Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga projekti i ristrukturimit të aeroportit "Nënë tereza" sh.a.

**14.** Për një ndryshim në vendimin nr.124, datë 2.3.2005 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e

numrit të punonjësve buxhetorë të ministrive dhe institucioneve qendrore për vitin 2005".

**15.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Kërkesë për Kuotim", për objektin "Ndriçimi i superstradës Kashar – Durrës".

## **II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 15.4.2005 PROJEKTLIGJE**

*(Vendime për propozime projektligjesh)*

**1.** Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit European, për pjesëmarrjen e republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të bashkimit European për menaxhimin e krizës në Bosnjë Hercegovinë (Operacioni "ALTHEA").

- Me vendimin nr .803, datë 26.11.2004 Këshilli i Ministrave e ka miratuar në parim këtë marrëveshje. Më 7 mars 2005 ministri i mbrojtjes zoti Pandeli Majko e ka nënshkruar këtë marrëveshje. Pas plotësimit të procedurave të mësipërme, tani propozohet projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshje nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**2.** Për ratifikimin e marrëveshjes detare, ndërmjet këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së republikës së Turqisë.

- Marrëveshja është nënshkruar në muajin Shkurt 2005 dhe ka si qëllim vendosjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve detare për zgjerimin e sigurisë dhe parandalimin e ndotjes detare, duke nxitur bashkëpunimin teknik, arsimor dhe krijimin e shoqërive të përbashkëta në të gjitha fushat detare.

Gjithashtu në marrëveshje përcaktohen rregulla të plota për zhvillimin normal të transportit de-

*(Vijon në faqen 3)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 2)*

tar midis dy vendeve, rritjen e shkëmbimeve tregtare, të mallrave dhe të udhëtarëve, të grupeve turistike, kulturore dhe sportive, si dhe krijohen kushte dhe hapsira për licensimin e shoqërive shqiptare dhe turke për të operuar në linja të rregullta detare të shërbimit për mallra dhe qytetarët.

**3.** Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor të veprimit të fqinjësisë "CARDS 2004".

- Nga projektligji del se ndihma financiare e BE-së për Shqipërinë, realizohet jo vetëm nëpërmjet programit CARDS, ndihmë kjo e drejtëpërdrejtë, por edhe në mënyrë indirekte nga programe komunitare, ndihma të parashikuara nga fondi europian i zhvillimit rajonal për vendet anëtare të BE-së.

Për të mundësuar aktivitetet që do të parashikohen të kryhen jashtë territorit të BE-së, Komisioni Europian hodhi idenë e krijimit të një instrumenti të ri të fqinjësisë (në të cilin merr pjesë edhe Shqipëria), financimi i të cilit do të sigurohet nga fondet e përcaktuara për programin CARDS. Për vitet 2004-2006 këto fonde do të jenë 45 milion për pesë vendet e Ballkanit Perëndimor.

**VENDIME të Këshillit të Ministrave data 15.4.2005**

**1.** Për miratimin e manualit kontabël të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

**2.** Për përcaktimin e kërkesave dhe të procedurave për miratimin e lejeve, të autorizimeve dhe të koncesioneve për përdorimin e ujit.

**3.** Për përcaktimin e disa shërbimeve në programin e kujdesit shëndetësor, spitalorpublik dhe dhënie koncesioni, arritje në mar-

rëveshje ose kontratë shfrytëzimi, administrimi apo mirëmbajtjeje.

**4.** Për një shtesë në vendimin nr. 579, datë 8.9.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e rregullave për kthimin e vlerave financiare kreditorëve, që kanë depozituar kapitalet etyre pranë shoqërive huamarrëse".

**5.** Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentin "Rregullorja e shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.839, datë 17-12.2004 të Këshillit të Ministrave.

**6.** Për disa shtesa në vendimin nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për ruajtjen dhe sigurimin e disa objekteve shtetërore" të ndryshuar.

**7.** Për miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime "Albetelekom".

**8.** Për miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime "Armo".

**9.** Për një ndryshim në vendimin nr.406, datë 19.6.1995 të Këshillit të Ministrave, "Për forcimin e rrjetit hidro-metereologjik dhe sizmologjik" të ndryshuar.

**10.** Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Slloake, për ristrukturimin dhe shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Slloake.

**11.** Për miratimin në parim të konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, jomateriale, Paris 2003.

**12.** Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Konfederatës Zviceriane, për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit.

**13.** Për miratimin në parim të Rezolutës REZ (2000) 7 të Këshillit të Europës për ndryshimet në statutin e Observatorit Audiovizional European.

**14.** Për lejimin e kryeministrit të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për blerjen e një sistemi të ri audio, në këtë institucion.

**15.** Për caktimin e pagës së drejtorit ekzekutiv dhe të raportit të pagës maksimale e minimale të punonjësve të Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve.

**16.** Për miratimin e lirit nga detyra të inspektoratit të përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës, z. Blendi Marika, dhe emërimit në këtë detyrë të z. Sokol Kraja.

**17.** Për krijimin dhe funksionimin e qendrës kombëtare të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore dhe për një shtesë në vendimin nr. 306, datë 27.6.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë".

**18.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë së zhvillimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), në kuadër të programit të komunitetit të energjisë së Europës Juglindore.

**19.** Për lejimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të përdorë procedurën "prokurim i drejtëpërdrejtë" për blerjen e llampave UV, bateri AA dhe bojë matrikuluese, për procesin zgjedhor të vitit 2005.

**20.** Për lejimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të përdorë procedurën "prokurim i drejtëpërdrejtë" për blerje kuti votimi, vula

*(Vijon në faqen 4)*



# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 3)*

(kode) sigurie, pinca, për procesin zgjedhor të vitit 2005.

**21.** Për dhënie fondi ndihme disa partive të reja.

## **III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 21.4.2005 PROJEKTLIGJE**

*(Vendime për propozime projektligjesh)*

**1.** Për disa ndryshime në ligjin nr.9075, datë 29.5.2003, "Për miratimin e kriterëve dhe termave kryesore të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë".

- Ndryshimet e bëra në ligjin në fuqi ndihmojnë në procesin e zgjidhjes së problemeve për borxhet e trashëguara duke vendosur kriterë dhe terma kryesore.

Veç kësaj, me këto ndryshime, për zgjidhjen e problemeve të borxhit me kreditorët e huaj, që nuk janë anëtarë të Klubit të Parisit do të përdoren një ose disa nga kriteret e përcaktuara pasi përdorimi i të gjitha kriterëve se bashku në të njëjtën marrëveshje është i pamundur.

**2.** Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për projektin e Spitalit të Përgjithshëm të Kavajës.

- Sipas marrëveshjes, kredia do të jetë 5.690.000 dollarë dhe në përfundim spitali do të garantojë shërbim shëndetësor bashkëkohor për popullin e qytetit të kavajës dhe të zonave përreth.

**3.** Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve".

- Konventa ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis vendeve anëtare dhe mbështetja e tyre për përshtatjen e legjislacionit për

mbrojtjen e varieteteve të reja bimore.

Aderimi në këtë Konventë është një nga kërkesat për integrimin në BE dhe krijon mundësi për kompanitë e huaja të prodhimit të farërave të shumëzohen varietetet etyre në Shqipëri, duke mbështetur edhe fermerët shqiptarë me material mbjellës bimor të varieteteve të reja.

## **VENDIME të Këshillit të Ministrave data 21.4.2005**

**1.** Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale dhe për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave "Për ngritjen e Agjencisë së Urbanizimit të Zonave Informale".

**2.** Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 449, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për tarifën në sektorin e pyjeve e kullotave".

**3.** Për miratimin e Dokumentit të Politikave të Zhvillimit, për programin e Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit e Zonës bregdetare.

**4.** Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Çeke, për zgjidhjen e borxhit të Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke.

**5.** Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar.

**6.** Për miratimin në parim të heqjes së aneksit të tretë "Parimet e mosdiskriminimit dhe konkurrencës në sistemin kompiuterik të rezervimit", që i bashkëlidhet ligjit nr.9185, datë 12.2.2004, "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Repub-

likës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të bashkuara të Amerikës, për transportin Ajror".

**7.** Për një shtesë fondi në buxhetin e viti 2005, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

**8.** Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme dhe kulturave të ndryshme bujqësore, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së re 110 KV Elbasan – Cërrik – Ibë.

**9.** Për miratimin e strategjisë "Konsolidimi i një sistemi plani – fillimi të integruar në Republikën e Shqipërisë".

**10.** Për lejimin e Ministrisë së Financave të përdorë procedurën "Kërkesë për Kuotim", për auditimin e projekteve, të fiancuara nga Banka Botërore, dhe të granteve.

**11.** Për disa ndryshime në vendimin nr.113, datë 25.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, për mbulimin e shpenzimeve për hartimin, nga njësitë e qeverisjes vendore, të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005".

**12.** Për miratimin e planit të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale.

**13.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Kërkesë për Kuotim", për objektin "Ndërtim rruga Vidhas – Kombinati metalurgjik, Elbasan".

**14.** Për një ndryshim në vendimin nr.88, datë 1.3.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e zonave, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit".

*(Vijon në faqen 5)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 4)

## IV. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 28.4.2005 PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8032, datë 16.11.1995 "Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e të nënprodukteve të tij", të ndryshuar.

- Ndryshimet e propozuara, kanë për qëllim zgjidhjen e problemeve në këtë shërbim, duke përfshirë parimin e promovimit të dhurimit vullnetar të pakompensuar si dhe importin dhe eksportin e gjakut dhe produkteve të përqëndrueshme të tij, në përputhje me aktet nënligjore.

2. Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera, me fonde shtetërore, nga Enti Kombëtar i banesave.

## VENDIME të Këshillit të Ministrave data 28.4.2005

1. Për miratimin e strategjisë së shërbimeve shoqërore.

2. Për përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivitet dhe investimet e aktivëve, për mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike, nga shoqëritë e sigurimit.

3. Për kriteret dhe masën e mbulimit financiar të kujdesit shëndetësor për ushtarakun e Forcave të Armatosura.

4. Për kushtet, normat dhe standardet, që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira, të cilat blihen në treg.

5. Për liçensimin e personave, fizikë e juridikë, si vlerësues të pasurive të paluajhtëshme.

6. Për dhënien në administrim të përkohshëm Albpetrol, sha.a-së, Patos, të një sipërfaqeje toke, të nevojshme për shpimin dhe vënien në shfrytëzim të pusit Delvina-34.

7. Për një ndryshim në vendimin nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit

të Ministrave, "Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës".

8. Për një shtesë në vendimin nr.143, datë 19.4.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e letër –marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së transportit dhe të Telekomunikacionit dhe zotit Henrich Hegemann".

9. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për shpenzimet e kryera për përballimin e emrgjencave nga reshjet e borës.

10. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, për mbulimin e shpenzimeve për përgatitjen e listave përfundimtare të zgjedhjeve nga njësitë e qeverisjes vendore për zgjedhjet parlamentare të këtij viti.

11. Për dhënie fondi ndihme partisë "Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut".

12. Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik.

13. Për dhënie mendimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar, për një shtesë në ligjin nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".

14. Për miratimin e protokollit të sesionit të 8-të të komisionit të përbashkët shqiptaro - turk, për bashkëpunimin ekonomik, tregtar, industrial dhe teknik.

15. Për disa ndryshime në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, "Për administrimin e rrjetit rrugor ko-

mbëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar.

16. Për miratimin në parim të marrëveshjes nr.1 për ndryshimin e marrëveshjes së huasë, të financimit dhe projektit, të datës 23.3.2000, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bankës Gjermane për Rindërtim (KFW), për projektin "Furnizimin me ujë dhe kanalizimet, Pogradec –Programi".

17. Për miratimin në parim të marrëveshjes financiare shtesë, për marrëveshjen financiare, të datës 22.5.2003, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bankës Gjermane për Rindërtim (KFW), për projektin "Furnizimi me ujë dhe kanalizimet, Pogradec – masat shoqërore".

18. Për miratimin në parim të marrëveshjes financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bankës Gjermane për Rindërtim, (KFW), për projektin "Kanalizime, Korçë".

19. Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe bankës për Zhvillim, të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e fazës së parë të projektit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.

20. Për fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të objektit "shërbim i lavanterisë dhe i pastrimit të brendshëm në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë Spitalin Obsentrik Gjinekologjik, nr. 1 e nr.2, Tiranë, dhe Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive. Tiranë.

# RAPORT

## NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE PËR MUAJIN PRILL 2005

*(Vijon nga faqja 1)*

mbledhjeve të komisionit deri në përgjysmimin e kësaj kohe nga një mesatare prej 60 minutash në 30 minuta për mbledhje. Ky ndryshim, bazuar në një vlerësim empirik, vjen edhe si rrjedhojë e afimit të zgjedhjeve të reja parlamentare dhe mbylljes së kësaj legjislatore.

### **Çështjet e trajtuara në mbledhjet e komisionit**

Në 12 mbledhjet e zhvilluara gjatë muajit mars janë shqyrtuar 11 projektligje: Nga këto:

- 5 janë ratifikime marrëveshesh;
- 3 janë projektligje që bëjnë rregullime tërësore;
- dhe 3 janë projektligje që propozojnë ndryshime në ligjet ekzistuese.

Nga 11 projektligjet e shqyrtuara 2 janë me iniciativë të deputeteve të veçantë ose grup deputetësh: P/ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004 dhe ligjin nr.9341, datë 10.1.2005. P/ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare".

Të gjitha projektligjet me përjashtim të Projektligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare". janë përfunduar (miratuar) në një mbledhje të komisionit. Ndërsa P/ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare" është shqyrtuar në 3 mbledhje dhe është përfunduar në një mbledhje të katërt të zhvilluar në muajin maj.

### **Konsultimi, ekspertiza dhe burimet e informacionit**

Në 11 mbledhjet e zhvilluara, për të mbrojtur propozimet ligjore dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të deputetëve, kanë qenë të pranishëm përfaqësues të qeverisë. Në përgjithësi, qeveria është përfaqësuar me drejtuesit dhe specialistët e sektorëve përkatës të ministrisë që është marrë kryesisht me përgatitjen e projektligjit. Në disa mbledhje ka qenë i pranishëm edhe Kryetari i Gjykatës së Lartë z.Thimio Kondi; Zëvendësministri i Drejtësisë z. Përparim Sanxhaku si dhe znj.Fatmira Laska nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Në mbledhje kanë qenë të pranishëm dhe këshilltarë të Kuvendit, që mbulojnë këtë Komision. Në shqyrtimin e projektligjeve në këto mbledhje nuk rezultoi të jenë zhvilluar seanca dëgjimi me grupe interesi ose me përfaqësues të komunitetit akademik. Pra, burimi i informacionit dhe konsultimit, gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komision ka qenë ai i Qeverisë dhe i Kuvendit.

### **Diskutime/Amendamente të bëra nga deputetët**

Nga 19 deputetë të Komisionit, vetëm 50% e tyre kanë propozuar amendamente në projektligjet që kanë qenë në shqyrtim. Nga këta, 4 deputetë kanë propozuar më shumë se dy amendamente. Mbi 50 % e anëtarëve të Komisionit kanë marrë pjesë aktive gjatë shqyrtimit të projektligjeve. Duke vlerësuar pjesëmarrjen në diskutim dhe amendamentet e propozuara të krijuar përceptimi që rreth 20 % e anëtarëve të Komisionit kanë një njohje paraprake të projektligjeve nëpërmjet konsultimeve që mund të kenë zhvilluar jashtë mbledhjes së komisionit. Deputetët janë më aktiv në shqyrtimet e projektligjeve tërësore ndërsa konstatohet një mungesë njohjeje dhe pjesëmarrjeje në projektligjet e tjera siç janë projektligjet për ndryshime ose shfuqizime dispozitash të veçanta dhe në veçanti projektligjet për ratifikime marrëveshesh, për aderime në konventa etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve konstatohet një pjesëmarrje më aktive e relatorëve të projektligjeve të ndryshme. Relatorët e projektligjeve propozojnë edhe më shumë amendamente pasi e kanë studiuar çështjen më mirë dhe janë më të përgatitur. Ndryshimi i ri që ka sjellë rregullorja e re e Kuvendit ka bërë që deputetët e caktuar për relatin e projektligjeve të bëjnë një konsultim dhe vlerësim më të plotë të projektligjeve të paraqitura.

### **Kontrolli parlamentar/ Çështje të tjera**

Përsa i përket kontrollit parlamentar, një tjetër funksion thelbësor ky i një Komisioni në Kuvend, KÇLAPDNJ ka zhvilluar 1 seanca dëgjimore:

1. Seancë dëgjimore publike për raportin e Inspektoriatit të lartë të Deklarimit të Pasurive.
2. Miratimi i Pr/rezolutës "Për vlerësimin e punës së Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive".

KÇLAPDNJ, në mbledhjen e datës 13.04.2005, zhvilloi seancën dëgjimore publike "Për raportin e Inspektoriatit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive.

Në seancën dëgjimore morën pjesë 90% e anëtarëve të KÇLAPDNJ. E pranishme ishte edhe znj.Fatmira Laska nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe media të ndryshme. Komisioni dëgjoi raportimin e bërë nga znj. Fatmira Laska e cila bëri një ekspozë të shkurtër të punës së këtij institucioni të pavarur në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij.

Pas raportimit, deputetët i drejtuan pyetje znj. Laska. Më pas diskutuan rreth raportit vjetor për

*(Vijon në faqen 7)*



**RAPORT**  
**NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË**  
**KOMISIONEVE PARLAMENTARE PËR**  
**MUAJIN PRILL 2005**

*(Vijon nga faqja 6)*

veprimtarinë e këtij institucioni. Në përfundim të diskutimeve të seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni vendosi për hartimin e një projektrezolutë për vlerësimin e punës së këtij institucioni, e cila u miratua më datë 20.04.05 dhe më pas u depozitua sipas procedurës për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Çështje të tjera që janë shqyrtuar në Komision gjatë muajit shkurt kanë qënë:

P/vendim "Metodika për vlerësimin e pronës së paluajtshme që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim". (Dhënie mendimi).

***Pjesëmarrja e deputetëve***

Nga 12 mbledhje të Komisionit të zhvilluara gjatë muajit prill, 4 deputetë kanë marrë pjesë vetëm në 30% të mbledhjeve të zhvilluara, 4 deputetë të tjerë kanë marrë pjesë në 50% të mbledhjeve, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve kanë marrë pjesë rregullisht në mbledhje. Por vetëm 1 deputet nga 19 anëtarë që ka Komisioni, ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e komisionit.

Në përgjithësi mbledhja nuk fillon pa u plotësuar numri i nevojshëm i deputetëve (kuorumi). Ka raste kur deputetët vijnë me vonesë dhe largohen nga mbledhja pa u mbyllur ajo, megjithatë edhe këta deputetë firmosin procesverbalin e prezencës në mbledhje.

Firmosja e listëprezencës nga anëtarë të komisionit pa qenë të pranishëm në mbledhje ka ndodhur shpesh gjatë muajit prill. Kjo, në radhë të parë, përbën një çështje etike që nuk duhet të lejohet nga komisioni. Së dyti, marrja e shpërblyerimit që është parashikuar për pjesëmarrjen në mbledhje pa qenë të pranishëm, e deformon këtë rregull duke zhvlerësuar synimin për rritjen e interesit dhe motivimin e deputetëve për veprimtarinë e komisionit parlamentar. Përsa i përket i procedurës së zhvillimit të mbledhjeve janë konstatuar shkelje porsa i përket miratimit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar kërkesë kjo e parashikuar nga rregullorja e re për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë muajit prill vetëm në dy mbledhje është miratuar procesverbali i mbledhjes së kaluar, ndërsa në rastet e tjera procesverbali nuk është miratuar nga deputetët madje nuk është përmendur fare.

**Informacion mbi faqet e**  
**internetit të Institucioneve**  
**Qëndrore**

**Kuvendi i Shqipërisë**  
[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

**Presidenca** [www.president.al](http://www.president.al)

**Këshilli i Ministrave**  
[www.keshilliministrave.al](http://www.keshilliministrave.al)

**Ministria e Financave**  
[www.min.fin.gov.al](http://www.min.fin.gov.al)

**Ministria e Mbrojtjes** [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al)

**Ministria e Mjedisit** [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al)

**Ministria e Shëndetësisë**  
[www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

**Ministria e Rendit Publik**  
[www.mpo.gov.al](http://www.mpo.gov.al)

**Ministria e Punëve të Jashtme**  
[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

**Ministria e Arsimit dhe e Shkencës**  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

**Ministria e Pushtetit Vendor dhe**  
**Decentralizimit**  
[www.mpvd.gov.al](http://www.mpvd.gov.al)

**Ministria e Transportit dhe**  
**Telekomunikacionit**  
[www.mtt.gov.al](http://www.mtt.gov.al)

**Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit**  
[www.mbu.gov.al](http://www.mbu.gov.al)

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe**  
**Sporteve**  
[www.mkrs.gov.al](http://www.mkrs.gov.al)

**Ministria e Industrisë dhe Energjitikës**  
[www.meep.gov.al](http://www.meep.gov.al)

**Ministria e Rregullimit të Territorit**  
**dhe Turizmit**  
[www.mrrtt.gov.al](http://www.mrrtt.gov.al)

**Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit**  
[www.minek.gov.al](http://www.minek.gov.al)

**Ministria e Integritit European**  
[www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al)

**Bashkia e Tiranës**  
[www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

**Departamenti i Administraës Publike**  
[www.pad.gov.al](http://www.pad.gov.al)

# Nga Punimet e Kuvendit për muajin prill 2005

## *(Vijon nga faqja 1)*

me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Parimi bazë i projektligjit është:

- Zyrtari duhet t'i kryejë vetëm në mënyrë ligjore detyrat dhe përgjegjësitë e veta;
- Zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë çdo gjendje të konfliktit të interesit;
- Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar kryerjen e detyrave nga zyrtarët në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe të parandalojë sa më parë dhe në mënyrë të frytshme konfliktin e interesave.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët propozuan disa amendamente për ndryshime e riformulime në disa nene të projektligjit. Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin, duke marrë në konsideratë edhe amendamentet e propozuara nga komisionet e përhershme të tij.

2. P/vendimi "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së pronës së paluajtshme që kompensohet dhe të asaj që do të shërbejë për kompensim", miratuar në seancë plenare më datë 28 prill 2005.

Ky projektvendim ka për qëllim të hartojë metodologjinë për vlerësimin e sipërfaqes së tokës bujqësore që do t'u kompensohet pronarëve të ligjshëm të saj. Sipas kësaj metodologjie, vlerësimi i sipërfaqes së tokës bujqësore bëhet në mënyrë indirekte, për shkak të mungesës së tregut real të tokës bujqësore dhe të mungesës së transparencës financiare të transaksioneve të shitblerjes së tokave bujqësore e të trojeve, duke synuar që vlera e përcaktuar të jetë sa më afër vlerës reale të tregut.

Vlerësimi i sipërfaqes së tokës bujqësore bazohet në kapitalizimin e vlerës së tokës në një sasi të tillë parash, që e vendosur në bankë, të japë interes vjetor të barabartë me fitimin neto të kësaj sipërfaqeje nga shfrytëzimi i saj për prodhime bujqësore. Si bazë për caktimin e vlerës së tokës është marrë "përshatshmëria ekonomike", e cila përcaktohet nga faktorë të tillë si potenciali agronomik i sipërfaqes së tokës, infrastruktura ekzistuese, potencialet e zhvillimit teknologjik, niveli i zhvillimit ekonomik të rajoneve bujqësore dhe strukturat e mbjelljeve.

Për të gjithë faktorët e përmendur më lart zbatohen koeficientët korrektues, të cilët llogariten sipas formulave të pasqyruara në anekset që shoqërojnë projektvendimin.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektvendimi në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komisionit Shitetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, disa anëtarë të këtij Komisioni, si dhe specialistët që kanë ndihmuar në hartimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së pronës.

Deputetët që përfaqësojnë shumicën parlamentare në diskutimet e tyre mbështetën metodologjinë e hartuar nga specialistët, duke theksuar se vlerësimi i përcaktuar prej saj është objektiv, përderisa edhe nga vrojtimet e bëra në disa zona të vendit çmimet e shitjes së tokave variojnë në vlerat +- 5 deri 10 për qind nga çmimi i tokës i llogaritur sipas kësaj metodologjie.

Deputetët e opozitës e mbështetën në parim metodologjinë, por ata ishin kundër përdorimit të sistemit të koeficientëve teknikë për vlerësimin e tokës, i cili sipas tyre, krijon hapësira për abuzivitet në vlerësim. Ata shprehën mendimin se për të arritur në një vlerësim më real të tokës, duhet të përdoret një numër i madh modelesh në zona të ndryshme të vendit, duke marrë për bazë sistemet e prodhimit, rendimentet e marra në kulturat bujqësore, çmimet e produkteve bujqësore etj. Për këtë arsye, deputetët opozitarë u shprehën kundër projektvendimit. Deputetët e shumicës parlamentare argumentuan se përdorimi i koeficientëve teknikë ndihmon në arritjen e një vlerësimi më real të tokës. Ata theksuan se kjo metodologji do të zbatohet në mikrozona, duke mbajtur në konsideratë faktorët që veprojnë në çdo zonë.

Gjatë diskutimit deputetët bënë disa vërejtje e propozime për përmirësimin e metodikës dhe të anekseve shoqëruese, me qëllim që t'i japin asaj formë ligjore, si dhe për ta saktësuar e thjeshtuar atë.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektvendimin me shumicë votash me disa ndryshime të propozuara nga komisionet e përhershme të tij.

3. P/ligji "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar", miratuar në seancë plenare më datë 14 prill 2005.

Qëllimi i këtij projektligji është:

- T'i japë kompetencë enteve prokuruese që të prokurorin fondet për kryerjen e shërbimeve komplekse në institucionet shëndetësore spitalore publike dhe të shërbimeve të tjera të ngjashme me

*(Vijon në faqen 9)*



# Nga Punimet e Kuvendit për muajin prill 2005

*(Vijon nga faqja 1)*

to, sipas vlerës së plotë të objektit të prokurimit. Pra, projektligji heq kufizimin e deritanishëm që kontrata për kryerjen e këtyre shërbimeve lidhet me afat deri në mbylljen e vitit buxhetor.

- T'i japë kompetencë enteve prokurorese që të gjykojnë vetë për procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë, në rastin kur një furnizues ose kontraktues ka të drejtën ekskluzive për mallrat, ndërtimet e shërbimet. Pra, në këto raste entit prokurores i jepet e drejta të vendosë vetë, pa marrë miratimin paraprak të Agjencisë së Prokurimit Publik.

- T'i japë kompetencë enteve prokurorese të përdorin prokurimin e drejtpërdrejtë për kryerjen e investimeve, projekteve dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit që lidhen drejtpërdrejt me çështjen e sigurisë në burgje.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në Komisionin e Përhershëm për Ekonominë dhe Financat dhe në seancë plenare ishin të pranishëm Kryetari i Agjencisë së Prokurimit Publik, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe specialistë të Ministrisë së Drejtësisë.

Deputetët opozitarë mbajtën qëndrimin e tyre kundër projektligjit. Ata ishin të mendimit se prokurimi i fondeve publike dhe caktimi i fituesit për një periudhë disavjeçare krijon hapësira për korrupsion. Veç kësaj, ata u shprehën që vlerësimi i rasteve të ekskluzivitetit duhet të bëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe nuk i duhet lënë në kompetencë enteve prokurorese, pasi edhe kjo krijon mundësinë e korrupsionit.

Projektligji u mbështet nga shumica e deputetëve, të cilët ishin të mendimit që këto ndryshime ligjore janë të drejta. Prokurimi i fondeve publike për disa shërbime komplekse për një periudhë mbi një vit buxhetor ndikon në përmirësimin e cilësisë së këtyre shërbimeve, në rritjen e investimeve për makinë, pajisje, specializim personeli etj. Ata u shprehën se prokurimi i përvitshëm i fondeve i hap rrugë korrupsionit.

Gjithashtu, ata u shprehën dakord edhe me decentralizimin e procedurave të prokurimit në rastet e ekskluzivitetit për mallrat, ndërtimet dhe shërbimet, e cila do t'i lehtësojë këto procedura.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi me shumicë votash që ta miratojë projektligjin, duke kërkuar nga Qeveria përshpejtimin e punës për përmirësimin rrënjësor të ligjit "Për prokurimin publik", për ta përputhur atë me legjisllacionin e vendeve të tjera të rajonit.

## II. Raportime të institucioneve të pavarura

1. Raporti i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, shqyrtuar në seancë plenare më datë 18 prill 2005.

Kryetari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Ilirian Celibashi, paraqiti para Kuvendit raportin për vepërimtarinë e institucionit që ai drejton për vitin 2004, duke vlerësuar posaçërisht punën e këtij institucioni për rritjen e profesionalizmit në procesin e administrimit zgjedhjeve, rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe me forcat politike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.

Gjatë diskutimit rreth këtij Raporti shumica e deputetëve vlerësuan punën e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të OSCE-ODHIR-it, për rritjen e profesionalizmit në administrimin e procesit zgjedhor, për krijimin e infrastrukturës zgjedhore dhe për trajnimin e administratës zgjedhore, si dhe për rritjen e bashkëpunimit e transparencës me forcat politike të vendit.

Deputetët e opozitës shprehën qëndrimin e tyre kundër Raportit të paraqitur dhe theksuan se Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nuk i ka zbatuar si duhet funksionet e tij kushtetuese dhe ligjore, duke vënë theksin tek mangësitë në hartimin e listave zgjedhore, të cilat trashëgohen nga një proces zgjedhor në tjetrin. Gjithashtu, ata përmendën shkeljet ligjore të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për menaxhimin e fondeve buxhetore nga ky institucion, i cili ka vepruar në kundërshtim me procedurat e parashikuara në ligjin "Për prokurimin publik". Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi me shumicë votash një projektrezolutë, në të cilën vlerëson pozitivisht punën e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe paraqet objektivat që duhet të zbatojë ky institucion për vitin 2005, veçanërisht për organizimin e zgjedhjeve parlamentare.

# KALENDAR I

## 3 JAVOR (16 - 20 maj 2005) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E hënë, datë 16.05.2005 ora 18.00

**-Seancë Plenare**

1. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Qazim Tepshi nga Ministri i Financave
2. Përgjigje e deputetit Eqerem Spahia nga Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacioneve.

**Data 16 - 20 maj 2005**

**- veprimtaritë në Komisione**

1. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur".

**Komisionet për Çështjet Ligjore,  
Administratën Publike dhe  
të Drejtat e Njeriut,  
Komisioni i Jashtëm,  
Komisioni për Veprimtaritë  
Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.**

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes shtesë të huasë dhe të projektit, për marrëveshjen e huasë, të datës 24 korrik 1999, të ndryshuar me marrëveshjen shtesë të huasë dhe të projektit, të datës 5 tetor 2002, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Agjencia zbatuese e projektit) dhe KFW-së (Frankfurt ans Main) për projektin "Furnizimi me energji elektrike për Shqipërinë Jugore".

**Komisioni për Çështjet Ligjore,  
Administratën Publike  
dhe të Drejtat e njeriut,  
Komisioni i Jashtëm,**

**Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese,  
Tregtinë dhe Mjedisin,**

**Komisioni për Ekonominë dhe Financat.**

3. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi për shmangien e taksimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin".

**Komisioni për Çështjet Ligjore,  
Administratën Publike  
dhe të drejtat e njeriut,  
Komisioni i Jashtëm,**

**Komisioni për Ekonominë dhe Financat.**

4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet humanitare".

**Komisioni për Çështjet Ligjore,  
Administratën Publike  
dhe të drejtat e njeriut,  
Komisioni i Jashtëm,  
Komisioni për Integrimin.**

5. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes detare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë".

**Komisioni për Çështjet Ligjore,  
Administratën Publike  
dhe të drejtat e njeriut,  
Komisioni i Jashtëm,  
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese,  
Tregtinë dhe Mjedisin.**

6. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Rumanisë".

**Komisioni për Çështjet Ligjore,  
Administratën Publike  
dhe të drejtat e njeriut,  
Komisioni i Jashtëm,**

**Komisioni për Ekonominë dhe Financat.**

7. P/Ligji "Për inspektoriatin shtetëror të ndërtimit".

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për  
Veprimtaritë Prodhuese,  
Tregtinë dhe Mjedisin.**

8. P/Ligji "Për disa ndryshime në Ligjin nr.8553, data 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

**Komisioni përgjegjës: Komisioni Për  
Sigurinë Kombëtare**

9. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, data 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

**Komisioni Përgjegjës: Komisioni për  
Punën, Çështjet sociale  
dhe Shëndetësinë.**

*(Vijon në faqen 11)*

# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 10)

10. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.7843, data 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

11. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8701, data 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar.

**Komisioni Përgjegjtjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

12. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8136, data 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

13. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8032, data 16.11.1995 “Për Shërbimin e transfuzionit dhe kontrollit të gjakut e produkteve të tij”, të ndryshuar.

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.**

14. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.8894, data 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” të ndryshuar.

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat.**

15. Projektligji “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”

**Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat.**

16. Projektligji “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë**

17. Projektligji “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë “

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për Sigurinë Kombëtare**

18. Projektligji “Për pronësinë Industriale”.

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për veprimtaritë prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.**

19. Projektvendim: “Për ngritjen e Kompleksit të Ri Parlamentar”

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat.**

20. P/Ligji “Mbi hyrjen e transmetimeve numerike në Republikën e Shqipërisë”.

**Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Mjetet e Informimit Publik.**

**E enjte, datë 19.5.2005, ora 10.00**

**-Seancë Plenare**

1. Diskutimi për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri në 60 minuta)

2. Diskutimi në parim i projektligjeve:

2.1 P/Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur”

2.2 P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes shtesë të huasë dhe të projektit, për marrëveshjen e huasë, të datës 24 korrik 1999, të ndryshuar me marrëveshjen shtesë të huasë dhe të projektit, të datës 5 tetor 2002, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Agjencia zbatuese e projektit) dhe KFW-së (Frankfurt ans Main) për projektin “Furnizimi me energji elektrike për Shqipërinë Jugore”.

2.3 P/Ligji “Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi për shmangien e taksimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”.

2.4 P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet humanitare”.

2.5 P/Ligji “Për disa ndryshime në Ligjin nr.8553, data 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

2.6 Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.7843, data 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

2.7 Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8701, data 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar.

2.8 P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, data 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

2.9 P/Ligji “Për inspektoriatin shtetëror të ndërtimit”.

(Vijon në faqen 12)



# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 11)

2.10 P/Ligji “Për hyrjen e transmetimeve numerike në Republikën e Shqipërisë”.

2.11 Projektvendim: “Për ngritjen e Kompleksit të Ri Parlamentar”

2.12 Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.88, data 8.9.2003 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe të pagave të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive”.

Relator:

**E premte, datë 20.5.2005, ora 10.00**

**-Seancë plenare**

1. Diskutimi për çështje që nuk janë në rendin e ditës ( deri në 60 minuta)

2. Diskutimi në parim i projektligjeve:

2.1 P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes detare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

2.2 P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Rumanisë”.

2.3 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8136, data 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë”.

2.4 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8032, data 16.11.1995 “Për Shërbimin e transfuzionit dhe kontrollit të gjakut e produkteve të tij”, të ndryshuar.

2.5 Projektligji “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”

2.6 Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.8894, data 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” të ndryshuar.

2.7 Projektligji “Për pronësinë Industriale”.

2.8 Projektligji “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

2.9 Projektligji “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”.

## Njoftim

(Vijon nga faqja 1)

*për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, infomacionin mbi dokumentat zyrtare.*

*Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e infomacionit të kërkuar.*

*Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.*

*Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga auto-riteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.*

*Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;*

***“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.***

***Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30***

***Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP”.***

**Denada BRESHANAJ**

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/

Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;

[cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);

[www.ascdp.org](http://www.ascdp.org)